

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË "Voltaik Energy" SHPK**

Sot më datë 11. 10. 2019, palët e mëposhtme:

- Z. Ilirjan Shimili, i biri i Kadriut, i datëlindjes 06.10.1951, lindur ne Elbasan dhe banues ne Tirane, Rruga Bogdani, Pallati 19, Apt 16,

shpreh vullnetin e tij për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**Voltaik Energy**” sh.p.k. si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria “**Voltaik Energy**” Shpk, nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

2. Ortakët themelues

Shoqëria është themeluar nga Ortaku i mëposhtëm:

- Z. Ilirian Shimili

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**Voltaik Energy**” sh.p.k. do të jetë:

Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese të energjisë elektrike eolike, fotovoltaikë, hidrike dhe gjeotermale e marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i të gjitha lejeve dhe licensave të cilat mundësojnë zhvillimin e këtij aktiviteti në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë.

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës.

4. Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë “**Voltaik Energy**” sh.p.k. do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga Ismail Qemali, Kulla Fratari, Nr 27, Tirane

Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “**Voltaik Energy**” sh.p.k. është 10 000 Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortakët themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontributë në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Ortakut**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt notarial.

7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë “**Voltaik Energy** ” sh.p.k. është **Z Ilirjan Shimili**

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “**Voltaik Energy**” sh.p.k. në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyre avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjeter që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Ortaku

Ilirjan Shimili

